Gjatë takimit, Drejtorja Ekzekutive Floreta Luli-Faber i ka prezantuar Ministres Gjosha punën që ka bërë Dhoma Amerikane gjatë kësaj kohe, për të krijuar një klimë më të favorshme për biznesin vendas dhe atë të huaj për sa i takon pronësisë intelektuale dhe asaj industriale. Kreu i projektit të USAID-it, Rritje Albania, Z. Viktor Lubojevski ka folur mbi mbështetjen që projekti i USAID-it i ka dhënë çështjeve specifike të IPR-it, duke mbështetur në radhë të parë biznesin dhe sektorët më të prekur nga kjo problematikë.

Takimi me Ministren Gjosha ka shërbyer për të bërë një përditësim të punës që është bërë në bashkëpunim me të gjitha insitítucionet shtetërore që mbulojnë çështjen e IPR-it, për të krijuar një front të përbashkët lufte kundër këtij fenomeni që dëmton rëndë biznesin dhe redukton investimet e hujaja. Ministrja e Integrimit, duke vlerësuar përpjekjen disa vjeçare të Dhomës është treguar e gatshme të ndihmojë dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe ku Ministria e Integrimit mund të luajë rolin e vet.

Takimi me Ministren e Integrimit është pasuar edhe nga një tjetër takim në Ministrinë e Kulturës me znj. Mirela Kumbaro. I njëjti grup përfaqësues i AmCham-it, këtë herë kryesuar nga drejtuesi i Komitetit te IPR-it, Arsen Kurti, ka bërë një paraqitje të hollësishme të punës së Komitetit IPR-it dhe format e bashkëpunimit me Ministrinë e Kultures. Znj. Kumbaro është shprehur e hapur për të gjitha format e mundshme të bashkëpunimit, dhe ka paraqitur procesin e rishikimit në të cilin ndodhet Ministria e Kulturës. Në këtë proces rishikimi po kalon draft ligji i ri për të drejtën e autorit si dhe Zyra Shqiptare për të Drejten e Autorit. Në këtë takim u ra dakort për një bashkëpunim ndër institucional për javët dhe muajt në vijim në mbështetje të përmirësimit të mbrojtjes së të drejtës se autorit në Shqipëri.

Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit me pjesëmarrjen e Ministres së Kulturës, znj. Mirela Kumbaro, organizoi dy tryeza, konkretisht me përfaqësuesit e agjencive të Administrimit Kolektiv të të drejtave të autorit dhe atyre të lidhura që operojnë në Shqipëri; si dhe takimin me përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të interesit/ përfaqësues të subjekteve përdorues të pronësisë intelektuale.

Gjatë takimit u diskutuan problematikat e fushës, si problemet me ekzekutimin e ligjit, rritja e abuzimit dhe pirateria, mosvënia e gjobave ose masave administrative, vështirësia në identifikimin e subjekteve përdorues, etj. Në këtë takim pati përfaqësim nga Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit me specialistë përkatës, të cilët diskutuan mbi problematikat e hasura gjatë punës në terren dhe hapësirave ku është i domosdoshëm përmirësimi.

## Social networks and their marketing benefits for businesses

# WoBAC Committee Meets Regularly

**AmCham's Women in Business Active Committee, WoBAC, held has held its regularly scheduled networking meeting, where it discussed the committee's involvement in a major project -- the organization of a regional conference on womenin Albania.**



WoBAC Committee Chairwoman FluturaVeipi thanked MirelaArqimandrititifor the invitation and hospitality provided to members at her local business, the White House, and invited members to participate in all WoBAC meetings and bring their ideas for the 2014 work plan.

She updated WoBAC members of the recent activities of the committee, talking about meeting professional women invited by the U.S. Embassy in Tirana and links created with the group of female lawmakers in parliament.

The WoBAC chairwoman spoke about the two main aims that characterize the work plan of the committee for 2014. The first is to use the talents of each member to improve the committee's work, and, the second, to share experiences and learned skills with others.

Ms. Arqimandrite spoke about her idea for 2014 -- to organize in Albania an annual regional conference that has already taken place under the auspices of the State Department in Zagreb and Ohrid. She discussed her idea to apply to a State Departmentprogram, which provides grants for ideas that bring together women that are active in business. She said it would involve writing a concept note on a topic of theproposed event, which would then be submitted to the U.S. Embassy. An answer would then be provided if the application qualifies for this year's conference to be organized in Albania.

During the meeting, new members introduced themselves and talked about their experiences in business.There was a lot of interest on the impressions WoBAC members presented at the recent Ohridevent and the experience they had gained at the conference.The ideas received at the event, should they be further developed, would allow members to understand and implement practices learned in Ohrid.

Social networks have great potential if one knows how to use in business and provide great advantages and benefits for business leaders, experts told a meeting of WoBAC. In addition to networking at the committee meeting, it also served to train on the use of social networks in business. Representatives of the Harvard Club,led by IlirCiko, made a presentation for the AmCham members explaining the true meaning of social networking and how a business can use it for marketing purposes. How to spread information through social networks, the audience it creates, how to write to attract the attention of others -- all of these techniques were addressed at the training session for WoBAC and AmChamorganized at Hotel Doro City in a meeting hosted through the generosity of one of the WoBAC-committee members, AnilaLlakmani. During the meeting, members asked about the opportunities social networks provide for product promotion and advertising how efficient these networks are. The general opinion that exists on social networks nowadays is that they are there to create and foster friendships and relationships, but the invited experts explained that beyond that, they also serve to establish a potential audience for products or services that businesses offer.

## Rrjetet sociale dhe benefitet e tyre në marketingun e një biznesi

# Takimet e Radhës të Komitetit WoBAC

**Komiteti i Aktiv i Graves në Biznes është mbledhur në takimin e radhës së networkut dhe ka diskutuar mbi mundësinë e angazhimit të këtij komiteti në një projekt të rëndësishëm si ai i organizimit në Shqipëri të Konferencës Rajonale të Gruas.**

Kryetarja e Komitetit të WoBAC-ut, znj. Flutura Veipi ka falenderuar për ftesën dhe mikpritjen Mirela Arqimandritin, e cila ka mirëpritur anëtaret tek “Shtëpia e Bardhë” . Znj Flutura ka ftuar anëtaret të marrin pjesë në takimet e WoBAC-ut dhe të sjellin idetë e tyre për planin e punës 2014. Ajo i ka informuar anëtaret e WoBAC-ut mbi aktivitetet e fundit të Komitetit, duke folur për takimin që kishin me gra të tjera të ftuara nga Ambasada Amerikane dhe lidhjet që kishin krijuar me Alencën e Grave të krijuara nga deputetet në Parlament. Kreu i WoBAC-ut foli për dy qëllime që do ta karakterizojnë planin e punës së aktiviteteve të këtij Komiteti në 2014-ën; e para, tek aktivizimi i talentit që ka çdo grua dhe që duhet ta vendosë në punë dhe e dyta, tek dhënia dhe transmetimi tek të tjerët i eksperiencës dhe përvojës së fituar.



Mirela Arqimandriti ka folur për idenë e saj për të organizuar gjatë 2014-ës në Shqipëri, konferencën vjetore që është organizuar nga Departamenti i Shtetit në Zagreb dhe Ohër. Ajo ka shtjelluar idenë e saj për të aplikuar për këtë program në Departamentin e Shtetit, i cili nga ana e vet ka ofruar grante për idetë që sjellin gratë në biznes. Propozimi ishte të shkruajmë një Koncept Note mbi idenë që kemi për temën dhe organizimin e eventit dhe ta dorëzojmë atë në Ambasadën Amerikane dhe të presim përgjigje nëse kualifikohemi për të organizuar këtë vit konferencën në Shqipëri.

Gjatë takimit, të gjithë anëtaret kanë prezantuar vetveten dhe kanë folur për eksperiencat e tyre në biznes. Kanë qenë mjaft interesante përshtypjet e anëtareve të WoBAC-ut prezente në Takimin e Ohrit dhe eksperienca që kishin fituar në këtë Konferencë. Këto impulse ato i shprehën gjatë takimit dhe sollën mendimin se duhen zhvilluar duke mundësuar të tjera anëtare të njihen dhe të zhvillojnë praktikat e mësuara në Ohër.

Rrjetet sociale kanë potenciale që nëse di t'i shfrytëzosh i sjell mjaft benefite biznesit. Takimi i radhës i Komitetit të Grave në Dhomën Amerikane përveç se ka shërbyer si një network, i ka kushtuar vëmendje edhe trajnimit mbi përdorimin e rrjeteve sociale në biznes. Përfaqësuesit e Klubit të Harvardit, të drejtuar nga z. Ilir Ciko, kanë shpejguar përpara anëtarëve të Dhomës kuptimin e vërtetë të rrjeteve sociale dhe mënyrën se si një biznes mund ta shfrytëzojë për marketingun e vet.

Si mund të shpërndash informacion nëpërmjet rrjeteve sociale, audiencën që krijon, mënyrën se si duhet të shkruash për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve, janë disa nga teknikat që janë trajtuar në trajnimin që Komiteti i Graves në bashkëpunim me Dhomën Amerikne ka organizuar në Hotel Doro City. Takimi u mikprit me mjaft bujari nga anëtarja e këtij Komiteti znj. Anila Llakmani.

Gjatë takimit, anëtaret pyetën mbi mundësitë që të japin rrjetet sociale në promovimin e produkteve dhe se sa efikas mund të jetë reklamimi i tyre në këto rrjete. Mendimi i përgjithshëm që ekziston mbi rrjetet sociale sot për sot është se ato janë për të krijuar miqësi, por përtej kësaj mundësie, ngritja e një audience të mundshme që interesohet për produktet apo shërbimet e një biznesi është një mundësi që e ofrojnë sot rrjetet sociale.

# Member News

## Albanian International School

December began with the Albanian International School (AIS) attending the Christmas Bazaar at the Sheraton Hotel supporting the 'Organization for the Support of Albania's Abandoned Babies' (OSAAB). We had a great time meeting people from all over Tirana. AIS plans on adopting OSAAB as one of the charities in Tirana we will be supporting throughout the year. If you wish to help, please contact me.

AIS was pleased to host the Sunday lunch at the Sheraton by providing 30 bottles of wonderful Albanian wine. The wine was offered free to Sheraton guests and they seemed to enjoy the variety selected. Kantina Nurellari's red and white were both favorites as well as the Merlot from Kantina E Families Tufe from Lunder. AIS will be hosting the Sunday lunch at the Sheraton again on April 13th. Besides the wine we will be providing a Face Painter and art projects for the children.

The last day of the 1st semester and the last day of classes in 2013 found students singing Seasonal/Holiday songs. We were joined by students from the Iranian school who taught AIS students the Iranian national anthem. The two schools joined in singing the Iranian national anthem as a 'good-bye' to their friends, our students, returning to Iran after two years at AIS.

The Winter/Holiday celebration also saw the awarding of certificates to the best student, most improved student and the best artists in various grades. Everyone enjoyed the treats provided at the end of the celebration. That evening the teachers were treated to dinner at a local restaurant as a 'Thank You' for the end of the first part of what should be a great school year.

January has been quieter here at AIS. Students are studying hard and preparing for the Black History Month Celebration on Friday, February 28th at 1 pm. This will be a major production including songs and poems to tell the history of the African American experience in the U.S. Everyone is welcome.

We are happy to be welcoming Mr. SotiraqTrebicka to the AIS family as Administrative Coordinator and Ms. Nina Messenger as our new 1st/2nd grade teacher.

TIRANA BUSINESS PARK

While reading TBP (Tirana Business Park) your mind leads you towards unveiling a new investment in the country. In order to know more on this company and its project that bears the same name, we are presenting TBP to all members of the American Chamber of Albania, through a 10 question profile.

**1. What is TBP?** Tirana Business Park (TBP) is the largest real estate, direct, private, German investment in Albania, an investment of Lindner Group (LG) that reaches the value of 100 million euro. The total construction area of approximately 177,000 m2, are the home of the development of 15 buildings dedicated to office spaces and two multi-stories parking buildings.

2. Where is TBP located? The project is positioned, on the geographical viewpoint, as a neuralgic location, that offers various accesses through roads, maritime and air transport. TBP is located only 2 minutes away from the international airport "Mother Theresa", 20 minutes from the city centre, 30 minutes away from the port of Durres and 40 minutes away from the port of Shengjin. The unique position of this project interconnects the main highways of the country, as Durres- Kukes highway, Elbasan highway, the North and South Axis.

**3. Is there any other project similiar to TBP's size scale?** TBP is a unique project in the Albanian territories. However, the investor, Lindner Group, which bears 50 years of experience, as one of the leading companies in the European market, in the construction field has proved that the business park is a successful business model. We can mention as an example, Galvaniho Business Center, Slovakia, a business complex located within Avion commercial area, where the high quality buildings and the public infrastructure are effectively liaised to each other. Nevertheless, the project that marks the beginning of the success of the Lindner Group in this field is Business Park Sofia, located at the foot of Vitosha Mountain, conveniently reachable from all major boulevards, Sofia Ring Road and the metro.

**4. Have the construction works started and if so, at what phase?** Yes, TBP has started the first construction phase on August 2012. This phase that reaches the value of 20 million euro will develop the first three buildings, B05, B06 and B07, with one common underground floor (220 underground parking places) in a gross building area of 40 000 m2 . The class A buildings, 5-8 floors, with areas dedicated to office spaces 25 000 m2 and 5000 m2 retail area, in the ground floor of each building, offer a resistant structure and maximal flexibility, at a premium of any kind of business. Also, the modern infrastructure will be completed during the first phase – the drinking water treatment plant and waste water treatment plant, as well as the technical building which will serve and support dhe administration of the business park.

**5. When are the first offices ready to be used by the business community?** The construction and development of Tirana Business park is planned to be completed in 5(five) construction phases, and are foreseen to finish within 10 upcoming years. Meanwhile, since the completion of the the first phase, Tirana Busines Park tenants will experience the new concepts of the construction materials' technology, applied in the project, as well as, urbanism, architecture, landscape and infrastracture

**6. Why TBP should be the first choice?** TBP is the ideal place to develop your business, because through the dedicated package Business + and the implementation of the 'Business & Nature'philosophy, it induces a great motiviation to your employees. Tirana Business Park guarantees in a sustainable way, the adaptation of the changable needs for the dynamic business community, in general, and the demands of each particular client.

**7. Who are the future tenants of TBP?** All the visionary industries, present not only in the albanian market, but also in the Western Balkan and SouthEastern Europe; businesses that clearly understand the importance of being part of an international business community, in an excquisite sorrounding area and uncomparable infrastructure.

**8. What is the novelty that TBP brings to the business community?** At Tirana Business Park, the objects are combined beautifully with nature, by offering through this unique business environment, a green city within the city. Particular importance is given to the quality of services provided, facility management and professional administration, in a dynamic community, active from the early morning hours till late in the evening.

**9. How does the TBP marketing promotion differes from the others?** Tirana Business Park has chosen a unique strategy to promote

# Lajme Anëtarësh

## Albanian International School

Dhjetori filloi në Shkollën Ndërkombëtare Shqiptare (AIS) me pjesëmarrjen në Pazarin e Krishtlindjeve të organizuar në Hotel Sheraton në mbështetje të Organizatës për Mbështetjen e Foshnjave të Braktisura në Shqipëri (OSAAB). Aktiviteti kaloi shumë mirë me takime me njerëz nga e gjithë Tirana. AIS planifikon ta përfishijë OSAAB-in si një nga organizatat bamirëse në Tiranë që shkolla do të mbështesë gjatë gjithë vitit. Nëse dëshironi të ndihmoni në këtë aspekt, ju lutemi të na kontaktoni.

AIS priti dhe organizoi me kënaqësi një drekë të dielën në Sheraton, duke ofruar 30 shishe vere të mrekullueshme shqiptare. Vera iu ofrua falas vizitorëve të Sheratonit dhe duket se ata u kënaqen nga larmia e verërave. Kantina Nurellari ishte e preferuar me të kuqen dhe të bardhën e saj. U pëlqye edhe Merloti i Familjes Tufa nga Lundra. AIS do të organizojë një drekë të dielën në Sheraton përsëri më 13 prill. Përveç verës, do të sjellim edhe një vizatuesh fytyrash dhe projekte arti për fëmijët. Dita e fundit e semestrit të parë dhe dita e fundit të klasave për vitin 2013 i gjeti nxënësit duke kënduar këngë të sezonit të festave të fundvitit. Nxënësit e AIS u takuan me nxënësit e shkollës iraniane, të cilët i mësuan nxënësve të AIS himnin kombëtar iranian. Të dy shkollat u bashkuan duke kënduar si dhe për një festë me rastin e largimit të një nga miqve të tyre dhe një nga studentëve tanë që kthehej në Iran pas dy vitesh në AIS .

Festat e fundvitit ishin edhe koha për dhënien e certifikatave për nxënësit më të mirë, dhe ata me përmirësime më të mëdha si dhe nxënësit dhe artistët më të mirë në klasat e ndryshme. Të gjithë shijuan ëmbëlsirat në fund të ceremonisë. Atë mbrëmje mësuesve iu dha një darkë në një restorant si shenjë falenderimi në fund të pjesës së parë të një viti të mirë shkollor. Janari ishte më i qetë në AIS. Nxënësit janë duke studiuar fort dhe u përgatitën për festimin e Black History Month të premten, më 28 shkurt. Ky event do të përfshijë këngë dhe poezi për të treguar historinë e përvojën e afrikano-amerikanëve në SHBA. Gjithkush është i mirëpritur. Ne jemi të lumtur të njoftojmë se Sotiraq Trebicka i është bashkuar familjes së AIS si Koordinator Administrativ dhe Nina Messenger është mësuesja e re në klasën e parë dhe të dytë.

TIRANA BUSINESS PARK

Ndërsa lexon TBP (Tirana Business Park) mendja të çon drejt zbulimit të një investimi të ri në vend. Për t'u njohur me këtë kompani dhe projektin që mban të njëjtin emër, po e sjellim për të gjithë anëtarët e Dhomës Amerikane të Shqipërisë, përmes një paraqitjeje me 10 pyetje.

**1. Çfarë është TBP?** Tirana Business Park (TBP) është projekti më i madh, privat, gjerman në Shqipëri, investim i kompanisë Lindner Group (LG), me vlerë 100 milionë euro. Sipërfaqja e ndërtimit prej 177,000 m2 është streha ku do të ngrihen 15 ndërtesa të dedikuara për ambjente zyrash, në shërbim të bizneseve si dhe dy ndërtesa shumëkatëshe parkimi.

**2. Cila është vendndodhja e TBP-së?** Projekti është i pozicionuar nga pikëpamja gjeografike si një vendndodhje nevralgjike, që ofron mundësi qasjeje përmes mjeteve të transportit rrugor, detar dhe atij ajror. TBP ndodhet vetëm 2 minuta larg aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", 20 minuta nga qendra e Tiranës, 30 minuta larg Portit të Durrësit dhe 40 minuta nga Porti i Shëngjinit. Pozicioni i veçantë që ka ky projekt ndërlidhet drejtpërdrejt me akset rrugore kryesore të vendit si, Autostrada Durrës-Kukës, Autostrada e Elbasanit, Boshti i Jugut dhe ai i Veriut.

**3. A ka TBP modele të ngjashme të kësaj madhësie?** Në trevat shqiptare, ky është projekt unik. Por, kompania Lindner Group, e cila mbart me emrin e saj përvojën e më shumë se 50 viteve, si një ndër aktorët kryesorë të tregut europian, në fushën e ndërtimit, ka provuar se ky është një model i suksesshëm biznesi. Mund të përmendim projektin Galvaniho Business Center, në Sllovaki, që është një kompleks biznesi në brendi të zonës tregtare Avion, ku ndërlidhen me efektshmëri ndërtesat e cilësisë së lartë dhe infrastruktura publike. Gjithashtu, projekti që shënon dhe fillimin e suksesit të LG në këtë fushë, është Business Park Sofia, ndërtuar rrëzë malit Vitosha në Sofje, në kryqëzimin e bulevardeve kryesore, unazës së madhe dhe metrosë së Sofjes.

**4. A kanë nisur punimet dhe nëse po, në cilën fazë janë?** Po, TBP ka nisur fazën e parë të ndërtimit në gusht të vitit 2012. Kjo fazë e ndertimit, e cila arrin vlerën 20 milionë euro, do të zhvillojë tre objekte, B05, B06 dhe B07, me një kat parkimi të përbashkët nëntokësor (220 vende parkimi), në një sipërfaqe totale ndërtimi rreth 40 000 m2. Ndërtesat e klasës A, 5-8 katëshe, me hapësira për zyra afërsisht në 25 000 m2 dhe 5000 m2 mjedise tregtare, në katin përdhes, ofrojnë strukturë të qëndrueshme dhe fleksibilitet te larte, shume e kerkuar per ambientet e cdo biznesi. Po në këtë fazë, ndërtohet edhe infrastruktura moderne, - impianti i trajtimit të ujit të pijshëm dhe ai i ujrave të zeza, si dhe ndërtesa qendrore teknike për administrimin e objekteve

**5. Kur do të jenë gati zyrat e para për komunitetin e biznesit?** Ndërtimi dhe zhvillimi i Tirana Business Park është planifikuar të realizohet në 5 (pesë) faza ndërtimi, të cilat parashikohet të përfundojnë në 10 vitet e ardhshme. Ndërkohë, që në përfundimin e fazës së parë të punimeve, klientët e Tirana Business Park do të përjetojnë konceptet risi të teknologjisë së materialeve të ndërtimit, të zbatuara në projekt, urbanistikës, arkitekturës, peizazhit dhe infrastructures.

**6. Pse TBP duhet të jetë zgjedhja e parë?** TBP është vendi ideal për të zhvilluar biznesin tuaj, sepse përmes paketës së dedikuar Business+ dhe aplikimit të filozofisë 'Biznes & Natyrë', sjell për punonjësit e kompanive tuaja motivimin e duhur. Tirana Business Park garanton në mënyrë të pandërprerë përshtatje të nevojave të ndryshueshme, të komunitetit dinamik të biznesit, në tërësi, si dhe kërkesave të çdo klienti në veçanti.

**7. Cilët janë klientët e mundshëm të TBP?** Të gjitha industritë largpamëse, të pranishme jo vetëm në tregun shqiptar, por edhe në Ballkanin Perëndimor dhe Europën Juglindore; bizneset të cilat e kuptojne rëndësinë e një komuniteti ndërkombëtar, ambienteve mbresëlënëse dhe infrastrukturës së pakrahasueshme.

**8. Çfarë risie sjell TBP për komunitetin e biznesit?** Tek Tirana Business Park, objektet ndërthuren më së miri me natyrën, duke bërë që, ambienti i krijuar, të jetë një qytet i gjelbër brenda qytetit. Rëndësi e veçantë i është dhënë ofrimit të shërbimeve jashtëzakonisht cilësore si dhe administrimit profesional, në një komunitet dinamik që do të jetë aktiv nga orët e para të mëngjesit deri në orët e vona të mbrëmjeve.

**9. Nga dallon promovimi TBP-së nga të tjerët?** Tirana Business Park ka zgjedhur një strategji unike të promovimit të projektit. Kështu, kompania synon paraqitjen e projektit përmes filozofisë së eventeve rajonale të Road Show, të ndërmarra deri më tash në Bullgari (Sofje), Kosovë (Prishtinë), Kroaci (Zagreb). Këto prezantime kanë për qëllim jo vetëm zbulimin e risive të projektit, por edhe njohjen dhe promovimin e Shqipërisë si një treg

# Member News

the project. Therefore, the company aims to present the project through the philosophy of Road Shows' regional events, organized so far in Bulgaria (Sofia), Kosovo (Pristina), Croatia (Zagreb). The main goal of these activities is not only to unveil the novelties of the project, but also the introduction and promotion of Albania as a potential and an attractive market. Each presentation is organized as a panel discussions composed by well known Albanian Business and Albanian Institutions' representatives, not only by arising a high interest from the foreing businesses that have already considering investing in Albania, but also to get to know the country closer, in order to benefit from the advantages it offers. The road to the upcoming Road Shows will continue during the year 2014, in the European Economic Centers of Milan, Italy and Istanbul, Turkey in order to increase awareness of Albania can offer to the investors and also encourage new investments in the country.

**10. Which is TBP's moto?** We will change the way business is done!

### Trusted Education Provider Welcomes New Leadership

Tirana, Albania - Abraham Lincoln Foundation of Albania ('Lincoln Albania,' www.lincolnalbania.org) announced today that Gordon Schrank will lead the trusted language and professional education services provider. He succeeds Robb Provost, the founder, and now Chairman of Lincoln's Board of Directors. Mr. Provost, on behalf of the Board said, "We are thrilled to have Mr. Schrank joining us in Tirana. He comes with a tremendous amount of experience in the service sector and in leadership development. He will not only help us accomplish our goals in the years to come but will also add tremendous value to the business community in Albania."Having spent more than 30 years in the hospitality industry he comes to Lincoln Albania after leading one of the most profitable Chick-fil-A franchises in America. His expertise lies in customer service and leadership training. Adds Mr. Provost, "While we know that that the services we offer are different from his previous experience, we believe that his proven history in client care and staff development will only enhance our ability to serve our market in Albania. His addition is a game-changer for us."

Mr. Schrank joins Lincoln Albania as the President to continue delivering Lincoln's trusted education services to individual students and to top companies in Albania. "I am excited for the opportunity to work with the Lincoln leadership team in the heart of Tirana. There is much potential here in Albania and I am eager to do my part in helping to see the nation continue to develop."

Abraham Lincoln Foundation of Albania is a self-sustaining, not-for-profit educational services organization committed to Albanian national development.Lincoln Albania provides exceptional language and workforce development assessment and training services by employing dedicated, effective teachers, using premier curriculum, and developing customized experiences for our students. Through high quality instruction in modern languages like English, German, Italian, and Albanian for foreigners Lincoln Albania has trained more than 50,000 students since its beginning in 1997 including children, students, and professionals. For professional services, Lincoln partners with globally recognized experts to deliver tailored assessments and curriculum.

## BOGA & ASSOCIATES

LEGAL ▪ TAX ▪ ACCOUNTING

IFLR1000 "The Global Guide to the World's Leading Financial Law Firms" has now published the rankings in Financial and Corporate Law practice for the year 2014.

We are pleased to announce that in this 24th edition of IFLR1000 Global Guide Boga & Associates keeps ranking as "Top Tier Firm" and our corporate and financial lawyers as Leading Lawyers.

The Guide praises Boga & Associates as "a go-to firm for internationals searching for local counsel". It highlights 2013 as a solid year for the firm "strengthening its status at the top of the table". Genc Boga the Senior Partner of the firm, is viewed as leading the team and managed a number of the firm's top mandates from the last 12 months, advising lenders and borrowers on a full range of financing matters, including syndicated loans, project and asset finance, and rarer financial products such as factoring.

Among the firm's clients and remarkable advised transactions, IFLR1000 distinguishes European Bank for Reconstruction and Development, Limak Holding and Calik Distribution and Calik Energy.

Clients are satisfied with the quality standard received from the firm. One client said "We required assistance on a matter within a very short time frame. Jonida Skendaj was very responsive and provided clear, well thought-out advice".

Team leaders Genc Boga, Renata Leka and Alketa Uruci are listed as Leading Lawyers in Banking & Finance, Capital Markets and M&A for Albania, while Kosovo Country Manager of the firm and Partner, Sokol Elmazaj, is nominated as Leading Lawyer in Banking & Finance and M&A for both Albania and Kosovo.

The 24th edition of IFLR1000 sees Boga & Associates as contributor to the Albanian and Kosovo legal reviews as well, providing insights on the recent legal developments in both jurisdictions.

Year 2014 marks the 20th anniversary of Boga & Associates.

Boga & Associates, established in 1994, has emerged as one of the premier law firms in Albania, earning a reputation for providing the highest quality of legal, tax and accounting services to its clients. The firm also operates in Kosovo (Pristina) offering full range of services. Until May 2007, the Boga & Associates was a member firm of KPMG International and the Senior Partner/Managing Partner, Mr. Genc Boga was also Managing Partner of KPMG Albania.

The firm's particularity is linked to the multidisciplinary services it provides to its clients. Apart of the wide consolidated legal practice, the firm offers also a significant expertise in tax and accounting services with a keen sensitivity to the rapid changes in the Albanian and Kosovo business environment.

The firm is praised by clients and peers as a "law firm with high-calibre expertise", and is distinguished "among the elite in Albania".

# Lajme Anëtarësh

tërheqës, me potenciale të shumta. Në secilën nga këto paraqitje, janë organizuar panele diskutimi me figura të njohura të biznesit dhe institucioneve shqiptare dhe jo vetëm, duke zgjuar interes të lartë të bizneseve pjesëmarrëse për të njohur më nga afër Shqipërinë dhe avantazhet e saj në fushën e biznesit. Radha e prezantimeve, do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2014, në qendrat e rëndësishme ekonomike europiane të Milanos dhe Stambollit, duke bërë të mundur vënien në pah të asaj çka ofron Shqipëria për investitorët dhe nxitjen e bizneseve për investime të reja në këtë vend.

**10. Cila është motoja lëvizëse e TBP?** Ne do të ndryshojmë mënyrën e të bërit biznes!

LEARN FROM THE PEOPLE YOU TRUST

### Institucioni i besueshëm arsimor mirëpret Drejtuesin e ri

Tiranë, Shqipëri- Fondacioni Abraham Linkoln i Shqipërisë ('Lincoln Albania,' www.lincolnalbania.org) njofton sot se Z. Gordon Schrank do të udhëheqë këtë institucion të besueshëm arsimor në gjuhë të huaja dhe trajnime profesionale. Ai vjen në këtë pozicion pas Z. Robb Provost, themelues dhe tani Kryetar i Bordit Drejtues. Z. Provost, në emër të Bordit Drejtues tha: "Jemi të emocionuar që Z. Schrank po vjen të punojë me ne në Tiranë. Ai vjen me një eksperiencë të madhe në sektorin e shërbimeve dhe në zhvillimin e udhëheqjes. Ai jo vetëm do të na ndihmojë të realizojmë objektivat tona gjatë viteve të ardhshëm, por do t'i shtojë vlerë të madhe komunitetit të biznesit në Shqipëri."

Pasi ka punuar më tepër se 30 vite në industrinë e shërbimeve, ai vjen në Qendrën Linkoln pasi ka drejtuar një nga restorantet franchise më fitimprurës në Amerikë si Chick-fil-A. Fusha e tij e ekspertizës shtrihet në shërbimin ndaj klientit dhe trajnime për udhëheqjen. Z. Provost shton gjithashtu, "Jemi të vetëdijshëm se shërbimet që ne ofrojmë janë të ndryshme nga eksperienca e tij e mëparshme, megjithatë besojmë se puna e tij në kujdesin ndaj klientit dhe zhvillimit profesional të punonjësve vetëm do të rrisë aftësinë tonë për t'i shërbyer më mirë tregut në Shqipëri. Emërimi i tij është një game-changer për ne."

Z. Schrank vjen në Qendrën Linkoln në pozicionin e Presidentit duke e çuar më tej shërbimin e këtij institucioni të besueshëm arsimor ndaj individëve dhe kompanive më të mira në Shqipëri.

"Jam i kënaqur t'i dhuroj eksperiencën time ekipit drejtues të qendrës Linkoln dhe të punojmë së bashku për të rritur cilësinë e produkteve të gjuhës angleze dhe shërbimeve të tjera që u ofrohen shqiptarëve. Ne përpiqemi vazhdimisht të jemi më të mirët në Shqipëri për të plotësuar objektivat dhe nevojat e çdo studenti!

Fondacioni Abraham Linkoln i Shqipërisë është një organizatë vetë- finacuese që ofron shërbime arsimore jo me qëllim përfitimi dhe që i është përkushtuar zhvillimit kombëtar shqiptar. Qendra Linkoln ofron shërbime dhe testime të suksesshme për gjuhët e huaja dhe trainime profesionale duke punësuar mësues të përkushtuar dhe efikas, duke përdorur programe cilësore si edhe duke iu përshtatur nevojave të studentit. Nëpërmjet mësimdhënies cilësore për gjuhët e huaja si Anglisht, Gjermanisht dhe Italisht dhe gjuhë Shqipe për të huaj, qendra Linkoln ka trajnuar më shumë se 50.000 studentë që prej vitit 1997 përfshirë këtu fëmijë, studentë dhe profesionistë. Linkolni është partner me ekspertë të njohur ndërkombëtarë me qëllim që të ofrojë trajnime dhe testime profesionale.

## BOGA & ASSOCIATES

LEGAL ▪ TAX ▪ ACCOUNTING

IFLR1000 "The Global Guide to the World's Leading Financial Law Firms" (Guida Botërore e Zyrave Kryesuese Ligjore Financiare) ka publikuar klasifikimet e zyrave të specializuara në të drejten tregtare dhe financiare për vitin 2014.

Në këtë botim të 24-t të IFLR1000 Boga & Associates vazhdon të renditet vazhdon të renditet në rangun e Zyrave më të suksesshme ("Top Tier Firm"). Gjithashtu, edhe anëtarët e saj klasifikohen si Avokatë Kryesues ("Leading Lawyers") në fushat e të drejtës tregtare dhe financiare.

Boga & Associates vlerësohet në këtë botim si një zyrë që i "rekomandohet ndërkombëtarëve që janë në kërkim të avokatëve vendas". Gjithashtu, viti 2013 theksohet si një vit i susksesshëm për zyrën "duke fuqizuar pozicionin e saj në krye të tabelës".

Genc Boga, Partneri Senior i zyrës cilësohet si lideri i ekipit në menaxhimin e transaksioneve më të rëndësishme të zyrës gjatë 12 muajve të fundit, ku përfshihet konsulenca ndaj institucioneve financiare dhe shoqërive kredimarrëse, për të gjitha çështjet që lidhen me projektet e financimit përfshirë dhe ato të produkteve financiare të spikatura të tilla si factoring.

Ndër klientet dhe transaksionet më të rëndësishme të zyrës, IFLR1000 përmend Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Limak Holding dhe Çalik Distribution si dhe Çalik Energy. Klientët tregojnë se janë të kënaqur me standardet e cilësisë që ofron zyra. Ndër ta veçohet opinioni i një klienti i cili thotë: "Ne kërkuam këshillim për një çështje brenda një harku kohor shumë të shkurtër. Reagimi i Jonida Skëndaj ishte shumë proaktiv, me përgjigje të qarta dhe të mirëmenduara".

Partneret e zyrës Genc Boga, Renata Leka dhe Alketa Uruçi renditen si Avokatë Kryesues ("Leading Lawyers") për Shqipërinë në fushat e të drejtës financiare dhe bankare, tregjet e kapitalit dhe në fushën e të drejtës tregtare kryesisht në transaksionet e bashkimeve të shoqërive dhe transaksionet me kuotat e tyre, ndërsa Menaxheri i zyrës për Kosovën, Sokol Elmazaj, gjithashtu edhe Partner, renditet si Avokat Kryesues ("Leading Lawyer") për Shqipërinë dhe Kosovën në fushat e të drejtës financiare, bankare si dhe në praktikën e bashkimeve të shoqërive dhe transaksionet me kuotat e tyre. Boga & Associates në botimin e 24-t të IFLR1000 kontribuon me artikuj që paraqesin zhvillimet e reja ligjore në Shqipëri dhe Kosovë.

2014-a shënon 20 vjet të Boga & Associates. Boga & Associates është themeluar në vitin 1994 si një nga zyrat e para ligjore në Shqipëri, duke fituar reputacion për ofrimin e shërbimeve ligjore, fiskale dhe kontabël të cilësisë më të lartë klientëve të saj. Zyra operon gjithashtu në Kosovë (Prishtinë) duke ofruar një gamë të plotë të shërbimeve. Deri në Maj 2007, Boga & Associates ka qenë anëtare e KPMG International dhe Partneri Senior/ Menaxhues i Boga & Associates Genc Boga ka qenë gjithashtu Partneri Menaxhues i KPMG Albania.

Veçoria e zyrës lidhet me shërbimet multidisiplinare që ofron për klientët e saj. Përveç praktikës së gjerë e të konsoliduar ligjore, zyra ofron gjithashtu një ekspertizë të konsiderueshme fiskale dhe shërbime kontabile, me një ndjeshmeri të mprehtë ndaj zhvillimeve në mjedisin shqiptar dhe kosovar të biznesit.

Klientët dhe kolegët e vlerësojnë Boga & Associates "me ekspertizë të kalibrit të lartë" dhe si një prej zyrave më në zë "në elitën shqiptare".

# ADMINISTRATIVE COURT PROCEEDINGS ARE MORE BUSINESS ORIENTED

The Law on Administrative Courts no.49/2012, effective in November 2013, provides a thorough reform of the system of administrative jurisdiction in Republic of Albania. Through this article, I intend to make a brief presentation of the main parts of this new law and, in particular, of the new elements brought by the law.

The new law provides for the first instance administrative courts, administrative court of appeal, and for the administrative section of the Supreme Court, which all together constitute the administrative court system in Albania. Now, lawsuits against administrative acts, including individual administrative acts and secondary normative acts, and related to administrative contracts and other administrative actions, need to be submitted to an administrative court: for example, lawsuits against tax assessment notification of the regional tax office, etc., need to be lodged to the competent administrative court.

The law provides that administrative court proceedings are to be handled more rapidly and to be more citizen and business oriented: a bunch of administrative court cases are subject to a one-stage court revision, there are specific defined deadlines for the transfer of a court file from one court instance to another and for the judgment of the case, the court case is not dismissed due to failure of the parties in litigation to be present in the court hearings and, in the majority of cases, the first instance administrative court awards the decision through a sole judge.



Av. Ardjana Shehi
KALO & ASSOCIATES
Head of Tax and Legal
Committee AmCham

Another important elements brought by the new law is that the public administration has the burden of proof, and that the parties in litigation have the right to benefit from the usage of "the expert of the parties in litigation" who participate in the court proceedings in the capacity of a witness.

In addition to the new procedural rules, for the time being, consideration must also be given to few transitional provisions for proceedings pending on the date of the new law effectiveness.

The introduction of the new Law on Administrative Court is perhaps the most important legal development related to Albanian judiciary happening in these recent 20 years. However, it remains to be seen whether the new provisions will actually produce the expected simplification and acceleration of administrative court proceedings, which is particularly important for the business.



# GJYKATAT ADMINISTRATIVE NË NDIHMË TË BIZNESIT

Ligji për Gjykatat Administrative nr.49/2012, i cili hyri në fuqi në nëntor 2013, parashikon një reformë tërësore të sistemit të juridiksionit administrativ në Republikën e Shqipërisë. Me këtë shkrim, synoj të bëj një paraqitje të shkurtër të përmbajtjes kryesore të këtij ligji të ri dhe, në veçanti, të detajeve të reja të sjella nga ky ligj.

Ligji i ri parashikon për gjykatat administrative të shkallës së parë, gjykatën administrative të apelit, dhe kolegjin administrativ të Gjykatës së Lartë, të cilët në tërësi formojnë sistemin e gjykatës administrative në Shqipëri. Tashmë, kërkesë paditë kundër akteve administrative, përfshire aktet administrative individuale dhe aktet nënligjore normative, dhe që kanë të bëjne me kontratat administrative dhe veprimet e tjera administrative, duhet të paraqiten para gjykatës administrative: për shembull, kërkesë paditë kundër njoftim vlerësimeve tatimore të zyrave rajonale tatimore, etj., duhet të paraqiten në gjykatën administrative kompetente.



Ligji parashikon se procedurat e gjykimit administrativ duhet të jenë më të shpejta dhe më në ndihmë të qytetarit dhe biznesit: një numër i çështjeve gjyqësore administrative janë objekt i gjykimit me një shkallë, ka afate të veçanta të përcaktuara për transferimin e dosjeve gjyqësore nga një shkallë në një shkallë tjetër gjykimi dhe për gjykimin e çështjeve, çështja gjyqësore nuk pushohet për shkak të mospranisë së palëve në seancë gjyqësore, dhe në shumicën e rasteve gjykatat e shkallës së parë marrin vendim me një gjyqtar të vetëm.

Një detaj tjetër i rëndësishëm i sjellë nga Ligji për Gjykatat Administrative është që organet e administratës publike kanë barrën e provës, dhe se palët në proces kanë të drejtën që të përfitojnë nga përdorimi "ekspertit të palëve", të cilët marrin pjesë në procesin gjyqësor në cilësinë e dëshmitarit.

Në vijim të rregullave të reja procedurale, për momentin, kujdes i duhet kushtuar dispozitave të pakta tranzitore, të cilat janë të zbatueshme për çështjet në proces gjykimi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit.

Miratimi i Ligjit të ri për Gjykatat Administrative ka gjasa të jetë zhvillimi më i rëndësishëm ligjor në lidhje me sistemin gjyqësor në Shqipëri në këto 20 vitet e fundit. Megjithatë, mbetet për t'u parë nëse dispozitat e reja ligjore do të mundësojnë thjeshtëzimin dhe përshpejtimin e shumëpritur të procedurave gjyqësore për çështjet administrative, e rëndësishme kjo veçanërisht për biznesin.

TIRANA BUSINESS PARK







# “We’ll change the way business is done”









Tirana Business Park
Rr. Ibrahim Rugova
Sky Tower 8/4
Tirana | Albania

T +355 4 44 15 154
info@tiranabusinesspark.com
www.tiranabusinesspark.com